

Republika e Shqiperise
Dhoma e Noterise
Nr.rep 892 Nr.kol 275



KONTRATE SHITJEJE (TRANSFERIM) AKSIONESH

Sot me 24.1.10.2001, ne zyren e Noterise Tirane, me seli ne rrugen e Duresit , perpara meje Noterit Publik Artemisa Meçaj u paraqiten personalisht te meposhteshenuarit :

a) **SHITESI**

ROBERT DAKO, I biri i Rekos dhe Marikes, lindur ne Tirane me 24.02.1957, banues ne rrugen "Lord Bajron", pallati 53/8, shtetas shqiptar , posedues i pasaportes nr.0372063, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, aksioner i Shoqerise Tregtare "ATLANTIK "SH.A., zoterues i 3.1% te aksioneve te kesaj Shoqerie , e barabarte 310 aksione, me vlere 3.100.000 leke(tremiljonenjqindmije leke).

b) **BLERESI**

DRITAN CELAJ, i biri i Rrapos dhe Dallandyshes, lindur ne Berat, me 27.08.1968, banues ne Vlore, lagja Pavaresia, nr. 107, posedues I pasaportes nr. 17.226.75, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, aksioner i Shoqerise Tregtare "ATLANTIK "SH.A., zoterues i 90% te aksioneve te kesaj Shoqerie , e barabarte me 9.000 aksione, me vlere 90.000.000 leke(nentedhjetemiljon leke)

te cilet me kerkuan hartimin e kesaj kontrate shitje (transferim) aksionesh , ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992"Per Shoqerite Tregtare", neni 705 I Kodit Civil, Ligji 8081 date 07.03.1996 "Per veprimtarite e sigurimeve dhe risigurimeve", Ligjit 7667 date 28.01.1993 " Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare

Shoqeria Tregtare "ATLANTIK "SH.A.ME Seli ne Tirane , eshte themeluar dhe eshte njohur si Person Juridik ne baze te vendimit te Gjykates se rrethit Tirane nr. 25.720 date 02/05/ 2001.....

Kapitali themeltar i kesaj shoqerie ne momentin e themelimit , pasqyruar ne Akt Themelim dhe Statutin e kesaj shoqerie , rezulton 100.000.000Leke (njeqindmiljon leke) , I perbere nga 10.000 (dhjete mije) aksione nominale, me vlere nominale 10.000leke, ne te cilen aksioneret marrin pjese si me poshte :.....

ROBERT DAKO zoterues i 3.1% te aksioneve te kesaj Shoqerie , e barabarte me 310 aksione, me vlere 3.100.000 leke (tremiljonenjqindmije leke).



DRITAN ÇELAJ, zoterues i 90% te aksioneve te kesaj Shoqerie , e barabarte me 9000 aksione, me vlere 90.000.000 leke,(nentedhjetemiljon leke)

DERVISH HASKAJ, zoterues i 4.9 % te aksioneve te kesaj Shoqerie , e barabarte me 490 aksione, me vlere 4.900.000 leke,(katermiljon e nenteqindmije leke).....

MERITA ALIU zoteruese i 2% te aksioneve te kesaj Shoqerie , e barabarte me 200 aksione, me vlere 2.000.000 leke,(dymiljon leke)....

Me vendim nr. 62 Date 03/09 2001 te Asamblese se Pergjithshem te Aksionereve eshte miratuar shitja e aksioneve te **ROBERT DAKOS** , dhe blerjen e tyre nga askioneri i po kesaj shoqerie **DRITAN ÇELAJ**.....

Duke zoteruar aksionet e mesiperpermendura "shitesi" konfirmon pjesemarjen e tij ne "shoqeri", dhe prej sasise se aksioneve percaktohet tituli dhe e drejta e pjesemarjes ne "shoqeri".....

Pala e pare, **Shitesi ROBERT DAKO**, deklaroi pa asnje pengese , ne pronesi dhe zoterim te plote , sasine e aksioneve te qe pershkruhen hollesisht me siper, ne shoqerine anonime me emrin Shoqeria Tregtare "ATLANTIK "SH.A., me seli ne Tirane, Shqiperise.

ROBERT DAKO deklaroi me vullnet te lire dhe te plote se bazuar ne te drejten qe buron prej tyre ,dhe te drejten qe ai ka mbi to, ai i shet me transferim 3.1% te aksioneve te kesaj Shoqerie , 310 aksione, me vlere 3.100.000 leke(tremiljonenjqindmije leke), duke ja kaluar ne pronesi dhe zoterim te plote , karshi shumes se blerjes te gjithe te drejtat dhe detyrimet, aktivin dhe pasivin, qe buron nga ky kapital , bleresit **DRITAN ÇELAJ** , karshi shumes 3.100.000 (tremilijon e nenteqind mije)leke , shume te cilen bleresi deklaroi se e ka shlyer plotesisht, jashte kesaj zyre, dhe qe i pergjigjet vleres se aksioneve te transferuara.....

Keshtu "shitesi" **ROBERT DAKO** heq dore nga cdo titull dhe e drejte lidhur me zoterimin e aksioneve te mesiperpermedura dhe njeh dhe emerone "bleresin" **DRITAN ÇELAJ** si te vetmin pronar dhe zoterues te atyre aksioneve, dhe ai qe tani eshte i lire te veprone , konform ligjit.....

"Shitesi" , nepermjet ketije dokumenti kontrate shitje aksionesh garanton si me poshte:

1)Te gjitha aksionet e lartpermedure te "shoqerise", dhe te transferuara , jane te lira nga cdo bare ,huamarje, konfiskim, pretendime personash te trete, apo dyshime , gjithashtu garanton aksionet te lira nga cdo detyrim ligjor.....

2)Te gjitha aksionet e mesiperpermdura te "shoqerise" per te cilat jane dhene dhe titujt perkates te perkohshem, jane shpallur dhe nenshkruar konform ligjit dhe vlera e tyre eshte reale dhe e kontrollueshme.....

3)Kapitali aksioner i "shoqerise" Kapitali themeltar i kesaj shoqerie ne momentin e themelimit , pasqyruar ne Akt Themelim dhe Statutin e kesaj shoqerie , rezulton 100.000.000Leke (njqindmiljon leke) , I perbere nga 10.000 aksione nominale, me vlere nominale 10.000leke.....

4)"Shoqeria" deri ne daten e sotme vepron normalisht branda kuadrit ligjor dhe nuk eshte objekt ndalimesh apo anulimesh nga gjykata e Tiranës, nga e cila u miratua , bazuar ne statut dhe ne aktin e themelimit.....

5)"Shitesi" kalon tek "bleresi" teresisht 310aksione te cilat perbejne 3.1% te kapitalit aksioner te "shoqerise", ne vleren 3.100.000leke.....

"Bleresi" deklaroi ju vune ne dispozicion te tije , per studim dhe kontroll, te gjitha librat ekonomike dhe te bilancit te "shoqerise"

Pas neshkrimit te kesaj kontrate bleresi DRITAN ÇELAJ behet pronar, zoterues i 93,1 % te aksioneve te kesaj Shoqerie , e barabarte me 9.310 aksione, me vlere 93.100.000 leke (nentedhjetetremiljonenjqindmije leke), dhe shitesi ROBERT DAKO nuk ka me asnje lloj te drejte mbi aksionet e kesaj shoqerie.....

Kapitali aksioner i "shoqerise" Kapitali themeltar i kesaj shoqerie ne momentin e themelimit , pasqyruar ne Akt Themelim dhe Statutin e kesaj shoqerie , rezulton 100.000.000Leke (njqindmiljon leke) , I perbere nga 10.000 aksione nominale, me vlere nominale 10.000leke, ne te cilen aksioneret pas neshkrimit te kesaj kontrate marrin pjese si me poshte

1***DRITAN ÇELAJ**, zoterues i 93.1% te aksioneve te kesaj Shoqerie, e barabarte me 9310 aksione, me vlere me vlere 93.100.000 leke (nentedhjetetremiljonenjqindmije leke).....

2***DERVISH HASKAJ**, zoterues i 4.9 % te aksioneve te kesaj Shoqerie , e barabarte me 490 aksione, me vlere 4.900.000 leke,(katermiljon e nenteqindmije leke).....

3***MERITA ALIU** zoteruese i 2% te aksioneve te kesaj Shoqerie , e barabarte me 200 aksione, me vlere 2.000.000 leke,(dymiljon leke).....

Mbas mareveshjes se mesiperme , qe u pranua nga te dy palet ne kontrate , u konfirmua transferta e kapitaleve dhe e titujve , u mbajt protokolli dhe shenimet e nevojeshme lidhur me transferen ne fjale, gjithashtu transferta u regjistrua dhe ne librat e shoqerise, dhe nje kopje te depozitohet ne zyren e regjistrimit tregetar ne Tirane, dhe te behen pasqyrimet perkatese te ndryshimeve te mesiperme.....

Konforem me sa me sipër u hartua ky dokument , kontrate shitblerje aksionesh, ne dy (6) kopje origjinale , dhe mbasi u lexua u binden palet per permbajtjen u firmos nga te dy(2) palet ne kontrate dhe sejcili prej tyre



mori nga nje kopje originale, dhe une noterja vertetoj Kontraten e shitjes se Aksioneve konform ligjit.....

Kjo kontrate u perpilua dhe u nenshkrua ne date 04.10.2006, ora 18:00 ne kater flete.

SHITESI I AKSIONEVE

Robert Dato
Dato

BLERESI I AKSIONEVE

Dritan Celaj
[Signature]

NOTERI PUBLIK

